



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS LEPOSAVIQ

Numri i lëndës: 2024:152717

Datë: 22.08.2024

Numri i dokumentit: 06074245

P.nr.38/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Dega Leposaviq – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Qëndresa Tahiri Islami, me bashkëpunëtoren profesionale Edita Koliqi, në lëndën penale ndaj të pandehurve: M.U dhe L.R, për shkak të veprës penale: Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të Kodit (Nr.06/L-074) Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.888/23, të datës 29.05.2024, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me datë 12.08.2024, në mungesë të Prokurorit të Shtetit Muharrem Prekazi dhe të pandehurve M.U dhe L.R, me datë 13.08.2024 shpalli publikisht, ndërsa me datë 22.08.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

1.M.U, nga i ati D..., e ëma V..., e vajzërisë B..., i lindur me datë, në M..., me adresë të vendbanimit në fshatin K..., Komuna L..., i pa martuar, punon si vozitës, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal të identifikimit, serb, shtetas i Republikës së Kosovës.

2.L.R, me nofkën "...", nga i ati M..., e ëma M..., e vajzërisë J..., e lindur me datë, në R... – S..., me adresë të vendbanimit në rrugën "...", nr..., në L..., e pa martuar, studente, e gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal të identifikimit, serbe, shtetase e Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

SEPSE:

Mes datës 15.06.2023, rreth orës 11:45, në fshatin Koshtuticë, Komuna Laposaviq, të pandehurit me dashje, në bashkëkryerje dhe duke qenë të vetëdijshëm kalojnë vijën kufitare nga Republika e Serbisë në Republikën e Kosovës, në vendkalimin e paautorizuar kufitar në atë mënyrë që, zyrtarët policor nga njësia NJNSH, përmes shikimit të kamerave kanë vërejtur se të pandehurit kanë kaluar ilegalisht nga Republika e Serbisë në territorin e republikës së Kosovës, gjë të cilën e kanë pranuar edhe vetë të pandehurit,

-Me këtë kanë kryer veprën penale: Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata, në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 43, 69, 70 e 140 par.2 të KPRK-ës, dhe nenit 358, 364, 449, të KPP-së, ju:

SHQIPTON

Të pandehurit M.U

-DËNIM ME GJOBË në shumë prej 400 (katërqind) euro, i cili dënim duhet të paguhet brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmëria së këtij Aktgjykimi. Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që të pandehurit, dënimin me gjobë do të ia zëvendësoj në dënim me burgim, duke llogaritur për çdo 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguar, me një (1) ditë burgim.

Të pandehuriës L.R

-DËNIM ME GJOBË në shumë prej 400 (katërqind) euro, i cili dënim duhet të paguhet brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmëria së këtij Aktgjykimi. Në rast se e pandehura nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që të pandehurit, dënimin me gjobë do të ia zëvendësoj në dënim me burgim, duke llogaritur për çdo 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguar, me një (1) ditë burgim.

-Obligohet të pandehurit, që secili veç e veç t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 20 (njëzet) euro, po ashtu edhe në emër

të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 20 (njëzet) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

-Pala të dëmtuar nuk kishte.

A R S Y E T I M

Aktakuza

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.888/23, të datës 29.05.2024, ndaj të pandehurve: M.U dhe L.R, për shkak të veprës penale: Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Rrjedha e procedurës

Gjykata, me datë 12.08.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në praninë e palëve, Prokurorit të Shtetit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, Muharrem Prekazi dhe të pandehurve M.U dhe L.R.

Të pandehurit M.U dhe L.R, në seancën e shqyrtimit fillestar, pas njoftimit nga gjykata, me të drejtat e tyre në këtë fazë të procedurës penale, janë deklaruar dhe kanë pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës së prokurorisë.

Gjykata ka marrë mendimin e Prokurorit të Shtetit mbi pranimin e fajësisë të deklaruar nga të pandehurit.

Prokurori i Shtetit Muharrem Prekazi, propozoi Gjykatës që të miratoj pranimin e fajësisë të pandehurve, ngase është bërë në mënyrë vullnetare, konform dispozitave të nenit 242 të KPP-së dhe ka mbështetje në faktet e çështjes që përmban kjo aktakuzë. Nga gjykata ka kërkuar që të njëjtit ti shpallë fajtor dhe t'i shqiptohet një sanksion penal me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit. Si rrethanë lehtësuese ka propozuar pranimin e fajësisë, kërkim faljen premtimin e dhënë se në të ardhmen nuk do të veprojnë në formë të tilla, ndërsa si rrethanë rënduese, rëndësinë që paraqet kjo veprë penale dhe dashjen direkte.

Gjetjet e Gjykatës

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilin e ka deklaruar nga të pandehurit M.U dhe L.R, në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për

miratimin e pranimit të fajësisë për të pandehurit. Gjykata gjen se pranimi i fajësisë nga të pandehurit mbështetet në tërësi në provat që përmban kjo akuzë, siç janë: Raporti policor me numër të rastit 2023-YNC-045, i datës 15.06.2023, punuar nga zyrtari Fatmir Muli; Raporti policor me numër të rastit 2023-YNC-045, i datës 15.06.2023, punuar nga zyrtari Arsim Misini; Raporti hetues me numër të referencës 2023-YNC-045; Verifikimi i personave përmes sistemit SPMK; Verifikimi i personave dhe automjetit përmes sistemit BMS; Foto albumi nga shkresat e lëndës; Procesverbalet mbi intervistimin e të pandehurve, të datës 15.06.2023; si dhe shkresat tjera të lëndës. Të gjitha këto prova janë bindëse dhe formojnë në tërësi elementet inkriminuese, e që në bazë të tyre dhe pranimit të fajësisë nga të pandehurit, përtej çdo dyshimi vërtetohet se të pandehurit kanë kryer veprën penale: Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata gjen se pranimi i fajësisë është bërë nga të pandehurit në mënyrë vullnetare, pasi që kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë. Gjykata ia kishte tërheq vërejtjen të pandehurve se pas pranimit të fajësisë nuk mundet të shfrytëzojnë të drejtën në ankesë, lidhur me bazën për gjendjen faktike, të njëjti janë njoftuar se nëse e pranojnë fajësinë humbin mundësinë e kundërshtimit të provave në aktakuzë dhe mundësinë për paraqitjen e provave tjera, si dhe për faktin se pranimi i fajësisë sipas ligjit është një rrethanë lehtësuese që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit Gjykata mund të shqiptoj një dënim më të butë. Gjykata gjithashtu ka vërtetuar se aktakuza në këtë rast nuk përmban asnjë shkelje ligjore e as ndonjë gabim faktik dhe nuk ka bazë për hedhjen e akuzës.

Gjykata, bazuar në pranimin e fajësisë nga të pandehurit dhe mbi bazën e provave të cekura si më lartë, përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se të pandehurit M.U dhe L.R janë të përgjegjshëm dhe përgjegjës për veprën penale për të cilën akuzohen: Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për të cilën vepër penale është paraparë dënimi me gjobë deri në dymijë e pesëqind (2.500) Euro gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit:

Gjykata, lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurit M.U dhe L.R, ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-ës, e si rrethanë rënduese, Gjykata ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë, kontributin esencial të tyre në veprën penale, si dhe intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur.

Ndërsa si rrethanë lehtësuese, ka marrë për bazë faktin se të njëjtit kanë treguar sjellje të mira, kanë bashkëpunuar plotësisht me organet e rendit dhe drejtësisë që nga fillimi i procedurës kundër tyre, duke kontribuar kështu në zbardhjen e shpejtë dhe të plotë të këtij rasti, keqardhjen e shprehur dhe premtimin e dhënë së më nuk do të përsërisin veprime të tilla. Ndërsa, si rrethanë posaçërisht lehtësuese për të pandehurit është vlerësuar pranimi i fajësisë në tërësi për veprën penale që në hapje të shqyrtimit fillestar të çështjes.

Gjithashtu, me rastin e caktimit të dënimit me gjobë në këtë rast për të pandehurit, Gjykata përveç rrethanave të cekura, ka vlerësuar dhe ka marrë parasysh edhe kushtet dhe mundësitë materiale për pagimin e gjobës, duke vlerësuar se dënimi me gjobë i shqiptuar për të pandehurit është i përballueshëm për kushtet ekonomike të tyre.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, Gjykata vlerëson se shqiptimi i dënimit me gjobë ndaj të pandehurve është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurve. Po ashtu, Gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që t'i parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin për shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e procedurës dhe ato për paushall gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 358, 364, 449, të KPPK-ës nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Dega Leposaviq

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.38/2024, datë 22.08.2024

Bashkëpuntorja profesionale
Edita Koliqi

Gjyqtarja e vetme gjykuese
Qëndresa Tahiri Islami

KËSHILË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditë, nga dita e pranimi të aktgjykimit me shkrim. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët.